



K.DH.SH.II.nr.1019/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Sfinga” Shpk me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.A., kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.P., me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1513/17 të datës 09.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit Organit Shqyrtues të Prokurimit, e datës 28.07.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1513/17 të datës 09.06.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar në pikën I e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Sfinga” Shpk, ndërsa Anulohet vendimi i të paditurës, Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë me Nr.253/2017 i datës 08.08.2017 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek i padituri.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditurit, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovoj si të bazuar ankesën e paditësit, Organi Shqyrtues i Prokurimit ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës

Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1513/17 i datës 09.06.2021 të anulohet si i pa bazuar dhe njëherit të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit “Sfinga” Shpk me seli në Prizren të hidhet poshtë si e pa bazuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK), i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjeti se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin, PSH.Nr.253/17 i dt.08.08.2021, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Hedhet poshtë si e pa afatshme ankesa e OE ankues “Sfinga” Shpk me seli në Prizren, me nr. protokolli 253/17 e datës 03 gusht 2017, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Organizimi i festave tradicionale Flutura, Rock Live dhe Zambaku i Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622 17 2452 221/ 622 17 007 221, të shpallur nga autoriteti kontraktues-Komuna e Prizrenit (KK Prizren), pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues. Në pikën II, Pasi që, ankesa e OE ankesë “Sfinga” Shpk me seli në Prizren, është parashtruar jashtë afatit ligjor tek AK-KK Prizren, Obligohet, autoriteti kontraktues që të anulojë vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 31 korrik 2017, dhe të vazhdojë me procedurën e nënshkrimit të kontratës sipas vendimit për dhënie të kontratës të datës 18 korrik 2017. Në pikën III, Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar në Autoritetin Kontraktues-KK Prizren, jashtë afatit ligjor. Operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Në pikën IV. Obligohet OE ankues që konform nenit 36 pika 5 e Rregullores të Punës së OSHP-së në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kundër Vendimit të paditurit, paditësi inicicion konflikt administrativ, me padi i drejtohet gjykatës. Gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje juridike administrative, me dt. 20.05.2021, mban seancë të shqyrtimit kryesor në prezencë të palëve ndërgjyqëse, dhe pas

administrimit të provave, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, anulon Vendimin e organit të paditur, dhe çështjen e kthen te organi i paditur në rishqyrtim dhe rivendosje. Me arsyetim se nga vendimi i të paditurës të kontestuar me padi del se ai përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se në nenin 48 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoj edhe pretendimet e të paditurës të paraqitura në përgjigje në padi në seancë dhe vendimin e atakuar, mirëpo të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara dhe të pa argumentuara pasi që e njëjta nuk kishte arritur të konfirmojë me asnjë dëshmi se paditësi ishte njoftuar për eliminim nga procesi i tenderimit në formë të rregullt, e që më pas e njëjta përmes kësaj dëshmie të vlerësonte se paditësi kishte dorëzuar kërkesën për rishqyrtim jashtë afatit. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se e paditura me rastin e vendosjes kishte vepruar në kundërshtim me nenin 4 të rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktues, neni 104, 105 dhe 116 të Ligjit të Prokurimit Publik. Këto shkelje dhe të meta të cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej tridhjetë (30) ditësh në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim , përkatësisht pasi të konsiderojë të afatshme ankesën të lëshohet në shqyrtimin e saj, në mënyrë që ti mënjanojë të metat e cekura dhe të merr vendim të drejtë të bazuar me ligj, vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata nuk ka vendosur për kërkesën e paditësit për kompensimin e dëmit për faktin se në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes së kontestuar me padi, gjykata nuk ka autorizime ligjore të vendosë meritorisht çështjen, por vetëm bënë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të kontestuar. Për këtë propozim, gjykata është e detyruar të vendosë vetëm në rast kur e vendos çështjen në pajtim me nenin 67.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton “Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrative nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjet juridike të gjykatës, apo në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, kurse paditësi paraqet padi të re, gjykata do të anulojë aktin e kontestuar dhe si rregull, vetë do të vendosë për çështjen me aktgjykim. Aktgjykimi i tillë e zëvendëson aktin e organit administrativ”.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor konkludimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, andaj kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore dhe procedurale me anulimin e vendimit të atakuar me padi, sepse i njëjti nuk është i plotë dhe përmbajtjesor për tu vlerësuar ligjshmëria e tij si në vështrim të nenit 44 të LKA, sepse është i përfshirë me të meta esenciale. Organi i paditur është dashtë që duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të nxjerr vendim përmbajtjesor ashtu si parashihet me nenet 84 par.2 dhe 85, të LPA-së, i cili do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjen faktike të çështjes, bazuara në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ deklarimin bazës ligjore në të cilat bazohet akti. Arsyetimi të jetë i qartë dhe i argumentuar lidhur me mënyrën e vendosjes ashtu si parashihet në nenin 85 të LPA, kur me akt, kufizohen mohohen, shuhen apo preken interesat ligjore ose, vendosen detyrime apo ndëshkime. Nga këto fakte rezulton se i padituri me mënyrën e vendosjes ka nxjerrë vendim jo të drejtë dhe jo ligjor ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LPA-së. Andaj, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur kur e aprovon kërkesëpadinë e paditësit dhe çështjen e kthen te e paditura në rishqyrtim dhe rivendosje vendimin e organit administrativ si në vështrim të nenit 43, 46.2 lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA.

Sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Kolegji vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore. Sepse, nuk është kontestuese se vendimi i organit të paditur nuk është përmbajtjesor ashtu si parashihet me dispozitat e cituara si më lartë të LPA-së. Kurse sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi sepse vlerësoi se janë të paqëndrueshme, të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të një pas njëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1019/22, me datë 08.12.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**